



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1 Prot.

Rrogozhinë, më 29.01.2024

**VENDIM**

Nr. 1 , datë 29. 01. 2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR  
MUAJIN DHJETOR 2023 NGA FONDI I BLOK – NDIHMËS 6%**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 29.01.2024 mori në shqyrtim projekt-vendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.197.Prot datë 16.01.2024 “Për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% “.*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “ , i ndryshuar Ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” Kreu II pika 13 e VKM-së nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6 %” si dhe VKB-së Nr. 3 . datë 26.01.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për përfitimin e Ndihmës Ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për vitin 2022” Me propozim të komisionit të ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 159 datë 17.06.2020 “Për verifikimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2023 nga fondi i bllok - ndihmës 6 %.
- Në total 17 familje që plotësojnë të gjithë kriteret juridike dhe ekonomike për marrjen e ndihmës ekonomike.
2. Fondi total prej 63 001 (gjashtëdhjetë e tre mijë e një) lekë.

---

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



3. Këto familje trajtohen në një listë të veçantë me fondin 6% të bllok Ndihmës - Ekonomike, lista si më poshtë vijon :

**Njësia    Gosë                                    Shuma që përfitojnë**

|                  |            |
|------------------|------------|
| 1- Dizo Veliu    | 3 703 lekë |
| 2- Ali Vogli     | 3 703 lekë |
| 3- Xhevdet Rosa  | 4 752 lekë |
| 4- Atlije Huqi   | 5 940 lekë |
| 5- Rudin Aliu    | 3 703 lekë |
| 6- Bashkim Gjoni | 3 703 lekë |

**Njësia    Lekaj                                    Shuma që përfitojnë**

|                   |            |
|-------------------|------------|
| 1- Florinda Dedej | 1 525 lekë |
| 2- Bashkim Shaba  | 3 703 lekë |
| 3- Islam Doda     | 4 792 lekë |

**Njësia    Kryevidh                                    Shuma që përfitojnë**

|                  |            |
|------------------|------------|
| 1- Shyqyri Elezi | 3 703 lekë |
| 2- File Osma     | 3 146 lekë |

**Njësia    Rrogozhinë                                    Shuma që përfitojnë**

|                     |            |
|---------------------|------------|
| 1- Isa Tusku        | 3 703 lekë |
| 2- Kujtime Xhafa    | 5 720 lekë |
| 3- Hajrije Xhavara  | 3 703 lekë |
| 4- Fitnete Arapi    | 3 146 lekë |
| 5- Prandvera Andoni | 2 178 lekë |
| 6- Shpetim Fejzo    | 2 178 lekë |

---

**Adresa:** Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email: [brrogozhine@gmail.com](mailto:brrogozhine@gmail.com)




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Rrogozhinë.

**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.**

**KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2 Prot.

Rrogozhinë, më 29.01.2024

**VENDIM**

Nr. 2 , datë 29.01.2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR  
MUAJIN JANAR 2024 NGA FONDI I PUSHTETIT VENDOR**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 29.01.2024 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.271.Prot datë 18.01.2024, "Për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i pushtetit vendor".*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 " Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 " Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", VKM-së Nr.597, datë .04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" VKB-së Nr.77, datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023", VKB-së Nr. 3 . datë 27.01.2020 "Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor" Me propozim të komisionit "Për verifikimin e familjeve që jetojnë në vështirësi ekonomike" ngritur me Urdhërin e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Nr.227, datë 27.07.2021 , Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

- 1. TË MIRATOJË DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR MUAJIN JANAR 2024 NGA FONDI I PUSHTETIT VENDOR,**  
- Në total 10 familje që plotësojnë të gjithë kriteret juridike dhe ekonomike për marrjen e ndihmës ekonomike .
- 2. Fondi total prej 60 444 (gjashtëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë.**

---

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

3. Këto familje trajtohen në një listë të veçantë me fondin e Buxhetit Vendor, në zërin Buxhetor Ndihma Ekonomike për vitin 2024 llogaria 606-1004, lista si më poshtë vijon :

| Emër         | Atësi    | Mbiemër  | Shuma       | Nr. identifikimit | Vendbanimi |
|--------------|----------|----------|-------------|-------------------|------------|
| 1- Altin     | Banush   | Suta     | 5 760 lekë  | I20530047G        | Rrogozhinë |
| 2- Pasionata | Muhamet  | Xhafa    | 16 632 lekë | I75103026N        | Rrogozhinë |
| 3- Lirije    | Sulejman | Sinameta | 3 060 lekë  | G05223164K        | Rrogozhinë |
| 4- Landa     | Abaz     | Meka     | 5 220 lekë  | H75221052C        | Rrogozhinë |
| 5- Ervin     | Banush   | Murrani  | 1 800 lekë  | I30206046I        | Rrogozhinë |
| 6- Vjollca   | Shyqyri  | Gjini    | 3 060 lekë  | H25607036D        | Rrogozhinë |
| 7- Fiqiri    | Tafil    | Hunçi    | 5 220 lekë  | H60120050N        | Rrogozhinë |
| 8- Manola    | Syrja    | Serani   | 3 060 lekë  | H45608040P        | Gosë       |
| 9- Arjana    | Zyber    | Bubeqi   | 3 960 lekë  | I35612019R        | Kryevidh   |
| 10- Etleva   | Gezim    | Xhafa    | 12 672 lekë | I55310191V        | Rrogozhinë |

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3 Prot.

Rrogozhinë, më 29.01.2024

**VENDIM**

Nr. 3 , datë 29. 01. 2024


**PËR PËRCAKTIMIN E DISA KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE  
SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË  
RROGOZHINË**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 29.01.2024 mori në shqyrtim projektvendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.323.Prot datë 24.01.2024 "Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendosen në territorin e Bashkisë Rrogozhinë".*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " , i ndryshuar, neni 5, neni 6 shkronja "b", neni 10, pika 3, neni 13, pika 1, shkronja "a", neni 14, pika 4, neni 20, shkronja "dh", dhe neni 37, pika 1, të ligjit nr.10 279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative", "ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës", të ndryshuar, neni 5 pika 1, neni 10, neni 12, neni 23, neni 29 dhe neni 38, të ligjit nr.10 431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, neni 11, neni 12, neni 27, neni 35, neni 37 dhe neni 38, të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", neni 3 pika 32, neni 18 pika 3, neni 20 pika 1 dhe neni 31, pika 12, të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, dhe neni 34, të ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të ndryshuar, neni 4, pika 1, shkronja "c" të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, si dhe pika 7.7 shkronjat "m" dhe "n" dhe pika 7.8 shkronja "f", të Shtojcës 1 bashkëlidhur këtij ligji, udhëzimin nr.5, datë 26.11.2010 "Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis", neni 66, neni 73 dhe neni 76, të ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr.1096, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike", udhëzimit nr.230, datë 20.03.2013, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e funksioneve dhe detyrave specifike të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore" të

---

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com



VKM Nr 447 datë 16.06.2010 "Për miratimin "Rregullores së administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit" neni 34 , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak,

## V E N D O S I :

Miratimin e përcaktimit të disa kundrvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Rrogozhinë, si më poshtë :

### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

##### Objekti dhe qëllimi

1. Ky vendim ka si synim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt juridik, individ fizik që ushtrojnë aktivitetin e tyre apo që jetojnë në Bashkinë e Rrogozhinës.
2. Ky vendim përcakton kundërvajtjet administrative për shkeljen e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës së bashkëjetesës shoqërore në fushën e sigurisë publike, qetësisë dhe moralit publik, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe procedurën e konstatimit të kundërvajtjes dhe vendosjes së sanksioneve administrative për to.
3. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike/shtetërore, garantimi dhe zbatimin e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë së Rrogozhinës, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundërvajtjeve administrative që cenojnë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike.

#### Neni 2

##### Përkufizime

Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Strukturë konstatuese"**, është çdo punonjës i strukturave të Bashkisë së Rrogozhinës që ka për detyrë funksionale konstatimin dhe dënimin e kundërvajtjeve administrative, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon, i cili mund të jetë punonjës i Policisë Bashkiake, Drejtorisë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, Koordinatorët e Mbrojtjes së Konsumatorit apo dhe çdo strukture tjetër të ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë.
2. **"Bashkëjetesa shoqërore"** është tërësia e normave që përcaktojnë sjelljen/marrëdhënien e individëve në shoqëri, me qëllim ruajtjen e ekuilibrave të bashkëjetesës, nëpërmjet zbatimit të rregullit social, mbrojtjes së lirive e të drejtave individuale, sigurisë së jetës dhe veprimtarive të përditshme ekonomike-shoqërore, përfshirë këtu edhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit.



3. **“Funkcion i Bashkisë Rrogozhinë”** është fusha e veprimtarisë, për të cilën Bashkia si njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar, lirisht, tërësisht apo në një pjesë, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, sipas parashikimeve të ligjit 139/2015, përfshirë këtu lëshimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve përkatëse.

4. **“Hapësirë publike dhe hapësira në bashkëpronësi”**, janë hapësira, si trotuare, rrugë, sheshe, lulishte, parqe, shesh pushime shkalle në pallate, rrugëkalime e mjedise të tjera në përdorim publik, që janë të pacenueshme dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre në shërbim të përdorimit publik, përveçse përmes dokumenteve të planifikimit, të parashikuara nga ligji.

5. **“Veprim”** është çdo veprim i caktuar, i natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprim tjetër i ngjashëm, apo sjellja e natyrës vetjake e çdo individi/qytetari, i cili kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie, që licencohet apo jo, ose gjatë përdorimit të një të mire publike, që i nënshtrohet apo jo pajisjes me leje.

6. **“Licencë, leje, autorizim”** është akti administrativ, që i njeh cdo subjekti apo individi të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, të drejtën të kryejë një apo disa veprime në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

7. **“Sanksionet administrative”**, janë akte administrative që lëshohen ndaj subjekteve nga strukturat konstatuese si rrjedhojë e shkeljes administrative të konstatuara.

### Neni 3

#### Parimet bazë

1. Parimet themelore në bazë të të cilave udhëhiqet Bashkia Rrogozhinë dhe çdo strukturë e saj në veprimtarinë e tyre, janë: Ligjshmëria; Mosdiskriminimi; Mbrojtja e të dhënave personale. Paanësia dhe parimi i drejtësisë; Mbrojtja, garantimi i interesit publik dhe jetës e shëndetit të qytetarëve dhe kontrolli dhe llogaridhënia.

Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi të caktuar në territorin e Bashkisë së Rrogozhinës, përfshirë këtu miratimet apo autorizimet përkatëse, bëhet vetëm nëse:

a. Ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt nuk cenon apo mund të cenojë jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik, një të mirë publike, objektivat sociale dhe çdo interes tjetër publik dhe qytetar të kësaj natyre;

### Neni 4

#### Misioni dhe detyrat e strukturës konstatuese

1. Strukturat konstatuese, në varësi të Bashkisë Rrogozhinë, në përmbushje të misionit dhe sipas fushës së kompetencave të tyre kanë si mision ruajtjen dhe garantimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore nga kryerja e veprimeve dhe/ose mosveprimeve të kundërligjshme në fushën e infrastrukturës, shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor dhe sigurisë publike.

2. Çdo strukturë konstatuese, ka si detyrë të monitorojë, kontrollojë e të marrë masat në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për zbatimin e rregulloreve, urdhrave e udhëzimeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak apo kryetari i bashkisë, për probleme që lidhen me zbatimin e



këtij vendimi apo përmbushjen e funksioneve të Bashkisë Rrogozhine si njësi e vetëqeverisjes vendore.

#### Neni 5

##### **Bashkëveprimi me strukturat e tjera**

Në përmbushje të misionit dhe realizimit të detyrave, strukturat konstatuese të Bashkisë Rrogozhinë dhe Bashkia Rrogozhinë, sipas rastit dhe nevoja bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me strukturat dhe institucionet e tjera shtetërore.

#### KREU II

##### **KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

#### Neni 6

##### **Veprimtaria e lejuar në territorin e Bashkisë Rrogozhinë**

1. Në territorin e Bashkisë Rrogozhinë, përfshirë këtu hapësirat publike dhe ato private, lejohen të kryhen vetëm aktivitete dhe veprimtari që janë në përputhje me qëllimin e kryerjes së tyre, duke respektuar funksionin, kushtet e përdorimit dhe shërbimet e lejuara, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe të përcaktuara dhe të rregulluara në aktet administrative dhe normative të nxjerra nga Bashkia Rrogozhinë apo strukturat përgjegjëse të saj, nëpërmjet lëshimit të lejeve, autorizimeve dhe miratimeve përkatëse nga këto të fundit.
2. Çdo veprimtari apo aktivitet që ushtrohet në territorin e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse të lëshuara nga ky institucion.
3. Pavarësisht lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga entet publike shtetërore sipas fushës së kompetencave të tyre, çdo veprimtari apo aktivitet që zhvillohet apo synohet të zhvillohet në kundërshtim me këtë vendim, kriteret dhe rregullave të përcaktuara nga Bashkia Rrogozhinë, dënohet administrativisht dhe merren masa deri në mbylljen e aktivitetit që ushtrohet.

#### Neni 7

##### **Zënia në kundërshtim me rregullat të hapësirës publike**

1. Ndalohet zënia e hapësirës publike dhe hapësirave mbi apo nën të, në territorin e Bashkisë Rrogozhinë, qoftë edhe përkohësisht, me çfarëdo lloj sendi apo objekti pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo strukturës përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.
2. Zënia e hapësirës publike, veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me normat detyruese dhe rregullat e miratuara nga Bashkia e Rrogozhinës dhe legjislacioni në fuqi, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas këtij vendimi, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për kundërvajtjet administrative.
3. Në rastin e zënies së hapësirës publike në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Bashkia Rrogozhinë apo në rastet kur subjekti e ushtron ose zhvillon aktivitetin në këto hapësira publike pa lejen përkatëse, strukturat konstatuese, veprojnë në përputhje me sanksionet administrative të parashikuara në nenin 15 të këtij vendimi.



4. Në rastin kur subjekti kundërvajtjes rezulton, se është i padënuar administrativisht për shkeljen e konstatuar, atëherë struktura konstatuese vepron duke vendosur fillimisht dënimin administrativ “Paralajmërimin me shkrim”, sipas nenit 15, pika 1, shkronja “a” të këtij vendimi.

5. Në rastin kur, subjekti vijon të kryej aktivitetin apo rezulton të jetë përsëritës i të njëjtës shkelje administrative, struktura konstatuese vendos dënim me gjobë, duke mbajtur në konsideratë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, sipas parashikimeve të këtij vendimi. Subjekti ambulant, i cili refuzon të identifikohet apo në rastet kur struktura konstatuese e ka të vështirë e të pamundur identifikimin e tij, ka të drejtën të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit që ka kryer kundërvajtjen administrative.

6. Në rastin e kundërvajtësit, identifikimi i të cilit nuk mund të vërtetohet me anë të dokumenteve identifikuese, Policia Bashkiake liron hapësirën publike dhe e pasqyron në procesverbal bllokimin e mallit dhe ruajtjen e tij për një afat kohor prej 24 orësh nga momenti i konstatimit të kundërvajtjes administrative. Procesverbali/akt konstatimi përpilohet dhe nënshkruhet konform pikës 1 të nenit 13 dhe pikës 1 e 2 të nenit 14 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

7. Me paraqitjen e dokumenteve identifikues dhe kryerjen e procedurës përkatëse administrative, Policia Bashkiake nëpërmjet mbajtjes së procesverbalit përkatës, bën zhbllokimin dhe ja dorëzon mallin e bllokuar subjektit kundërvajtës.

8. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 7 të këtij neni, Policia Bashkiake, me urdhër të kryeinspektorit ngre një komision të përbërë prej jo më pak se tre punonjës për asgjësimin e mallit të bllokuar. Çdo veprim i komisionit dokumentohet me procesverbalin përkatës të asgjësimit.

9. E njëjta procedurë ndiqet nga Policia Bashkiake edhe në rastin kur kundërvajtësi është i identifikueshëm, por e ushtron aktivitetin dhe zënien e hapësirës publike në mënyrë të paautorizuar nga strukturat përkatëse.

#### **Neni 8**

##### **Kundërvajtjet administrative në fushën sigurisë**

Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e sigurisë publike, këto veprime:

- a. Zënia e trotuareve, rrugës dhe rrugëkalimeve që pengojnë lëvizjen për njerëzit dhe automjetet, pa miratimin e strukturës përgjegjëse;
- b. Hedhja e objekteve dhe sendeve të forta, që pengojnë zhvillimin normal të veprimtarive social kulturore, apo promovuese që zhvillohen në hapësirat publike;
- c. Përdorimi i banderolave dhe thirrjeve me përmbajtje fyese apo denigruese gjatë zhvillimit të aktiviteteve apo veprimtarive sportive, kulturore, fetare, artistike, si dhe gjatë zhvillimit të tubimeve dhe manifestimeve;
- ç) Hyrja e personave në ambientet ku zhvillohen aktivitete publike, apo promovuese, pa autorizimin e Bashkisë së Rrogozhinës;
- d. Braktisja e automjeteve ose i sendeve të tjera në rrugë, mjedise publike apo ambienteve të përbashkëta;




- e. Cenimi nëpërmjet bërjes së grafitëve ose shkrimeve, ndotjes me substanca të ndryshme apo me gërvishtja e ndërtesave private e publike apo objekteve të tjera publike, përveç rasteve kur kryhet në kuadër të veprimtarive artistike dhe me miratimin e strukturës përgjegjëse;
- f. Vendosja me ngjitje, kapsim apo çdo mënyrë tjetër, e afisheve ose postareve të ndryshme në ndërtesat private e publike apo në objekte të tjera publike, pa miratimin e strukturës përgjegjëse;
- g. Kryerja e veprimeve apo mosveprimeve, që vënë në rrezik jetën, shëndetin apo pronën e të tjerëve përmes vendosjes pa masa sigurie të vazove të luleve apo çdo send tjetër në parvazet e dritareve, ballkoneve, në tarraca apo në çdo pjesë tjetër të mjediseve publike, të përbashkëta apo private;
- h. Përdorimi i lëndëve piroteknike apo fishekzjarrëve në çdo mënyrë që vë në rrezik shëndetin, jetën, pronën apo ambientin, në kundërshtim me legjislacionin për përdorimin e tyre;
- i. Lëvizja e automjeteve në orët dhe vendet e rezervuara për këmbësorët;
- j. Dëmtimi i mjediseve publike apo të përbashkëta, duke mos u ndalur vetëm në: shkallët e fasadat e pallateve, lulishteve, stolave, monumenteve, statujave dhe këndeve të lojërave;
- k. Vendosja e pengesave të çfarëdo lloji për kufizim shpejtësie të lëvizjes të automjeteve si dhe ndërtimi i objekteve përkujtimore përgjatë rrugës, pa miratimin e organit përgjegjës publik;
- l. Kryerja e çfarëdo veprimtarie në afërsi dhe pranë rrugëve, që rrezikon sigurinë rrugore, jashtë normave të sigurisë të përcaktuara nga Kodit Rrugor dhe pa miratimin e organit përgjegjës publik;
- m. Zënia e vend parkimeve publike dhe vendeve ku lejohet parkimi në hapësirat pranë blloqeve të banesave me automjete më qëllim ekspozimin/ tregtimin e tyre apo qëllime të tjera biznesi;
- n. Qarkullimi me mjete motorike, biçikleta në shëtitore, parqe apo vende pushimi për qytetaret në orët e ndaluara sipas rregullave të përcaktuara nga Bashkia Rrogozhinë dhe strukturat përgjegjëse të saj;
- o. Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, i parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuar nga këshilli bashkiak ose kryetari i Bashkisë së Rrogozhinës.

## **Neni 9**

### **Kundërvajtjet administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës**

1. Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës, këto veprime:
  - a. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese në mjediset publike nga muzika në bar-kafe, restorante dhe/ose lokale të tjera shërbimi, jashtë orareve të përcaktuara nga lejet përkatëse dhe legjislacioni në fuqi;
  - b. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese të çfarëdo lloji në ambientet e përbashkëta të banimit;
  - c. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese, në zonat e banuara nëpërmjet borive;
  - ç. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese nga punimet/ndërtimet në mjediset publike dhe private, të kryera jashtë orareve të përcaktuara nga rregullat e fqinjësisë së mirë apo pa miratimin e organit përgjegjës publik;



- d. Djegia e mbeturinave apo ndezja e zjarreve në zonat e banuara, lulishte apo parqe në vende të papërcaktuara për këtë qëllim dhe pa lejen e strukturave përgjegjëse;
- e. Përdorimi i materialeve apo sendeve të ndryshme imituese, tymuese, rrezeve laser në ambiente të hapura dhe të mbyllura publike;
- f. Kryerja e garave të ndryshme në mjedise publike në qendrat urbane, parqe e lulishte në vende të pa miratuara për këtë qëllim nga organi përgjegjës publik;
- g. Zhvillimi i lojërave me top apo lojërave të tjera që cenojnë sigurinë dhe qetësinë në zonat e pushuesve në hapësira publike apo ambientet e përbashkëta, përveçse kur këto zhvillohen me leje të strukturës përgjegjëse apo në mjedise të posaçme të përcaktuara për këtë qëllim;
- h. Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje parashikuar në aktet nënligjore të miratuar nga këshilli bashkiak ose kryetari i Bashkisë Rrogozhinë.

#### **Neni 10**

##### **Kundërvajtjet administrative kundër moralit publik**

- 1. Përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e moralit publik, këto veprime:
  - a. Dalja zhveshur/nudo në mjedise publike;
  - b. Urinimi, defekimi apo të pështyri në mjedise publike;
  - c. Të bërëturit me fjalë dhe shprehje vulgare apo kryerja e veprimeve me gjeste vulgare në mjedise publike;
  - d. Veprimet apo sjelljet e çdo natyre që kanë për qëllim ngacmimin, fyerjen apo talljen ndaj njerëzve më aftësi të kufizuara, të moshuarve dhe të pambrojturve.
  - e. Dehja në mjedise të hapura dhe në mjedise të mbyllura publike kur shoqërohet me veprime që krijojnë shqetësim për të tjerët;
  - f. Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje parashikuar në aktet nënligjore të miratuar nga këshilli bashkiak ose kryetari i Bashkisë Rrogozhinë.

#### **Neni 11**

##### **Kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit**

- 1. Përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e mjedisit, këto veprime:
  - a. Djegia e mbetjeve urbane në territore private dhe publike, brenda vijës së verdhë të qytetit.
  - b. Dorëzimi (hedhja) i mbetjeve nga shërbimi i pastrimit në pusetat e elektrikut, ujësjellësit, basenet ujore, etj.
  - c. Dorëzimi i mbetjeve të vëllimshme, mbetjeve të ndërtimit, në kontenierët apo në vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane.
  - d. Dorëzimi në kontejnerë apo në mjetet e përdorura për grumbullimin e mbetjeve, i mbetjeve të lëngëta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mira, i substancave të ngrohta, ndezëse, të rrezikshme për më tepër mbetje të forta apo kafshëve të ngordhura.
  - dh. Dorëzimi i mbetjeve nga aktivitete prodhimi, përpunimi, trajtimi, etj. si dhe mbetje të papranueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në kontejnerët publik.



- e. Hedhja, derdhja ne trotuare e ujërave dhe mbetjeve të ndryshme nga pastrimi apo larja e lokaleve të shërbimit, dyqaneve, etj.
  - ë. Dorëzimi i mbetjeve urbane jashtë kontejnerëve.
  - f. Mungesa e koshit të posaçëm pranë subjektit të shërbimit tregtar.
  - g. Dorëzimi i pasistemuar, i papalosur apo i pambyllur në qese i mbetjeve tregtarë, si dhe mosdorëzimi i tyre në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga Bashkia.
  - gj. Moskryerja e pastrimit, lejimi i ndotjes dhe mosmirëmbajtja e territoreve private të zbuluara, për të larguar në çdo mënyrë mbeturinat.
  - h. Hedhja e mbeturinave jashte vendeve te percaktuara nga Bashkia – persona juridike dhe fizike.
  - i. Kryerja e selektimit manual, kërkimit apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontejnerë, etj. nga persona të paaautorizuar.
  - j. Hedhja, mbledhja dhe grumbullimi i materialeve, hekurishte apo çdo lloj mbetjeje dhe/ose të ricklueshme, në territore/hapësira publike apo dhe ambiente private që nuk janë miratuar nga Bashkia Rrogozhine për këtë qëllim.
2. Fillimin e aktivitetit dhe ushtrimin e tij pa leje mjedisore, për të gjitha veprimtaritë që për shkak të natyrës së tyre përdorin vazhdimisht gjeneratorë/ventilatorë apo çdo pajisje që shkakton ndotje akustike, nëpërmjet lëshimit të zhurmës në mjediset dhe zonave të banuara, si:
- a. Furra të prodhimit të bukës;
  - b. Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme;
  - c. Bare, restorante e lokale nate;
  - ç. Dyqane/vende të tregtimit të kafshëve/shpendëve shtëpiake, të shoqërimit dhe të luksit.
  - d. Gomisteritë, lavazhet apo serviset e që riparojnë mjete.
3. Shkelje të kryera në fushën e ndërtimit dhe të veprimtarive në funksion të saj, të shkaktuar nga subjektet ndërtues/investitorë, për kryerjen e veprimeve të mëposhtëm:
- a. Levizja e konteniereve te mbetjeve urbane nga vendi imiratuar nga Bashkia: persona juridike dhe fizike,
  - b. Ndotje te hapesires publike jashte rrethimit te kantierit te ndertimit nga inerte apo material te tjera ndertimore,
  - c. Mosndertimi i bazamenteve te konteniereve te mbetjeve urbane nga subjektet e ndertimit,
  - ç. Rastet kur kamionet, te cilet transportojne material ndertimore, nuk jane mbuluar dhe qe krijojne ndotjen e hapesirave publike, gjate transportimit,
  - d. Hedhje mbeturinave ndertimore jashte territorit te percaktuar per kete qellim nga Bashkia: per shoqerite e transportit,
  - dh. Te gjitha ata qe bllokojne kanalet kulluese apo vadites me ndertim te paligjshme te çfaredo lloji,
  - e. Per mbrojtjen e mjedisit, mosdhenia e informacionit per shkarkimin dhe transferimin e ndotesve nga operatori, duke i shkarkuar ne vende jo te caktuara nga Bashkia dhe ne baze te lejes mjedisore.



ë. Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuar nga këshillit bashkiak ose kryetari i Bashkisë së Rrogozhinës.

## Neni 12

### **Kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike**

Përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e infrastrukturës publike, këto veprime:

1. Ndërhyrje në rrjetin rrugor, si:

- a. Per demtim, carje dhe ndotje rruge,
- b. Per demtim, carje, ndotje trotuari,
- c. Per demtim bordure,
- ç. Per demtim, rrjetit kanalizimeve, bllokim pusete,
- d. Per vjedhje te zgares,
- dh. Per vjedhje kapak pusete,

2. Ndërhyrje në rrjetin elektrik rrugor dhe rrjetin e telefonisë, si:

- a. Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror;
- b. Dëmtimi i shtyllave,
- c. Demtimi i ndriçuesve te qytetit,
- ç. Përdorimi i shtyllave si suport per reklame,
- d. Nderhyrjet ne kuadrot e komandimit per ndriçimin publik,
- dh. Lidhjet e pamiratuara ne rrjetin ajror,
- e. Demtimii rrjetit ajror nga punimet pa leje.

3. Ndërhyrjet në rrjetin ujësjellësit, si:

- a. Lidhjet e pamiratuara në tubacionet e ujit;
- b. Dëmtimi i pusetave te kanalizimit.

4. Ndërhyrjet në hapësirat publike dhe të gjelbër, si:

- a. Ushtrim aktiviteti pa leje transporti: motokarro, autovetura, fugon, minibus, mjete me tonazh te larte,
- b. Mospajisje me leje veprimtarie per te gjitha subjektet qe ushtrojne aktivitet transporti, imbarkimin e mjeteve te tansportit, sherbime ne lyerje mjetesh, sherbime lavazho, parkime, gomisteri, zdruktari etj.
- c. Mospajisje me leje tregtim gazetari etj,
- ç. Mospajisje me leje per tregetim e sherbime ambulate, auto, dyqane dhe rulote,
- d. Mospajisje me leje per ushtrim aktiviteti "24-oresh",
- dh. Mospajisje me leje per zenien e hapesirave publike: reklama te zakonshme / elektronike.
- e. Mospajisje me leje per mjetet qe transportojne mbetje te ngurta ne qytet dhe zonat turistike,
- ë. Per vendosjen e posterave pa leje,
- f. Per çdo cope poster ne peme pa leje,
- g. Per çdo demtim te fasades, vendosje tabelash, pankarta pa leje,
- gj. Vendosje mbishkrimesh pa leje ne hapesira publiike,
- h. Gjoha per te gjitha kategorite e demeve.



### Neni 13

**Kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike.**

1. Përbëjnë kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, këto veprime:

a. Të sigurojnë, që në ambientet e përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, kafshët/shpendët e tyre të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët/shpendët e tjera, duke zbatuar detyrimin, që:

- Qeni duhet të mbahet nga pronari/kujdestari, me rrip jo më të gjatë se 1.5 (një pikë pesë) metra.
- Të vendosin maskat mbrojtëse për qentë e racave të rrezikshme: spic, hasky, rotvailer, pitbull, doberman, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser.
- Të shmangin ndotjen e ambienteve të përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirave publike nga kafshët/shpendët e tyre, dhe në rast ndotje, të pastrojnë ambientin pas defektimit.
- Të kryejnë vaksinimin e detyrueshëm vjetor kundër tërbimit.
- Të vaksinojnë dhe kontrollojnë pranë mjekut të klinikës veterinare, kafshët/shpendët e shoqërimit dhe ato të luksit.
- Të respektojnë mirëqenien e kafshëve/shpendëve të tyre.
- Ndalohet kategorikisht, mbajtja në errësirë të plotë, të përhershme dhe/ose të lidhur gjatë gjithë kohës i kafshëve/shpendëve shtëpiake, të shoqërimit dhe të luksit.
- Personat, të cilët mbajnë kafshë/shpendë shtëpiake, të shoqërimit apo të luksit, në banesa individuale apo në bashkëpronësi në zona të urbanizuara, janë të detyruar të mos lejojnë që ato të kryejnë ndotje dhe të shkaktojnë zhurma, duke u bërë shqetësim për pjesëtarët e tjerë të komunitetit, duke cenuar gëzimin e qetë të pronës së tyre.
- Mbajtja dhe/ose rritja e kafshëve, bagëtisë ose shpendëve të çdo lloji, pavarësisht numrit është e ndaluar brenda të gjitha njësive të banimit ose pronës së përbashkët.
- Mbajtja apo qarkullimi i kafshëve blegtoralë jo shtëpiake, në mjedise publike të qendrave urbane si: kuaj, lopë, dhen, dhi, derra, shpendë (pula) etj;
- b. Ndërsen kafshët kundër njëra – tjetrës ose përdor kafshën për luftime a shfaqje, që shkaktojnë dhimbje, dëmtime, plagosje ose ngordhjen e tyre.

2. Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuar nga këshillit bashkiak ose kryetari i Bashkisë së Rrogozhinës.

### Neni 14

#### **Masat parandaluese për kundërvajtjet administrative**

Përveç sanksionit administrativ të vendosur nga strukturat konstatuese për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim, kundërvajtësit i nënshtrohen edhe konfiskimit të sendeve/mallrave që kanë shërbyer apo që ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuara në këtë vendim.



### KREU III

## SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MËNYRA E CAKTIMIT TË TYRE

#### Neni 15

##### **Sanksionet/Aktet administrative**


1. Sanksionet/ Aktet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim janë:
  - a. Paralajmërimi me shkrim/ Akt Konstatimi;
  - b. Proces verbal për kundërvajtjet administrative, ku sanksionohet masa e gjobës.
2. Sanksioni “paralajmërim me shkrim” është akti i konstatimit, akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e detyrës për kundërvajtësit, që jepet për një shkeljet të një rëndësie të vogël dhe/apo kur ekzistojnë rrethanat lehtësuese.
3. Në rast përsëritjeje të kryerjes të së njëjtës kundërvajtje apo të një kundërvajtje administrative tjetër sipas këtij vendimi apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobë.

#### Neni 16

##### **Masa e gjobës për kundërvajtjet administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore**

Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në këtë vendim:

1. Për kundërvajtjet në fushën sigurisë dhe rregullave apo ndërhyrjet në hapësirat publike dhe të gjelbër, si: të parashikuara në nenin 7 dhe nenin 8, Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 20 000 (njëzetmijë) lekë.
2. Për kundërvajtjet të parashikuara në nenin 9, Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1000 (një mijë) leke deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
3. Për kundërvajtjet të parashikuara në nenin 10, Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 2 000 (dy mijë) leke deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
4. Për kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit, Koordinatorët e Mbrojtjes së Konsumatorit/ Sherbimet publike Bashkisë së Rrogozhinës, do të vendosë gjobë:
  - a. Në masën 5 000 (pesëmijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “i”, “j” te pikës 1 të nenit 11 dhe në masën 10 000 (dhjetë mijë) leke për konstatimin e parashikuar në shkronjen “h”, te pikës 1 të nenit 11. Dhe për çdo rast të përsëritur kjo masë do të dyfishohet deri në vlerën maksimale prej 20 000 (njëzetmijë) lekë;
  - b. Në masën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për konstatim të shkeljeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 11;
  - c. Në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për konstatim të shkeljeve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, te pikës 3 të nenit 11 dhe në masën 20 000 (njëzetë mijë) lekë, për konstatim të shkeljeve të parashikuara në shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë” te pikës 3 të nenit 11.
5. Për kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike, Koordinatorët e Mbrojtjes së Konsumatorit / Sherbimet publike vendosin gjobë:



- a- Në masën 5000 ( pesemije) leke për konstatim të shkeljeve të parashikuara në shkronjen “b” te pikes 3 te nenit 12 si dhe shkronjat “c”, “ç”, “f” te pikes 4 te nenit 12.
- b. Ne masen nga 5000 (pese mije) leke deri ne 10 000 (dhjetëmijë) lekë për konstatim të shkeljeve të parashikuara ne shkronjen “dh”, te pikes 4 te nenit 12.
- c. Në masën 10 000 (dhjetë mije) leke për konstatim të shkeljeve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “dh”, te pikes 1 te nenit 12, per konstatimet e shkeljes se parashikuara ne shkronjat “b”, “ç”, “d”, “dh”, “e” te pikes 2 te nenit 12, te shkronjes “a” te pikes 3 te nenit 12 si dhe konstatimet e shkeljes se parashikuara ne shkronjat “d”, “ë”, “g” dhe “h” te pikes 4 te nenit 12, ndersa per shkeljen e parashikuara ne shkronjen “a” te pikes 4 te nenit 12, veprohet ne baze te Ligjit Nr. 8378, date 22.07.1998, i ndryshuar “Kodi Rrugor”.
- d. Ne masen nga 10 000 (dhjetëmijë) lekë deri ne masen 20 000 (njëzetë mijë) leke, për konstatim të shkeljeve të parashikuara ne shkronjat “b” dhe “e” te pikes 4, te nenit 12.
- dh. Ne mase 20 000 (njëzetë mijë) leke per shkeljet e konstatuara ne shkronjen “d” te pikes 1 te nenit 12, shkronjat “a”, “c” te pikes 2 te nenit 12 si dhe shkeljet e konstatuara ne shkronjat “gj” te pikes 4 te nenit 12.
6. Për kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, Koordinatorët e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Rrogozhinë, do të vendosin gjobë:
- d. Në masën 1 000 (njëmijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 13, masë e cila dyfishohet në rast të përsëritjes së shkeljes brenda një periudhe 3 (tre) mujore nga pronari/kujdestari i kafshëve/shpendëve;
- e. Në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 13, masë e cila do të jetë e dyfishuar në rast të përsëritjes së shkeljes nga pronari/kujdestari i kafshëve/shpendëve;
7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 4 dhe 5 të këtij neni, kur Policia Bashkiake konstaton në kryerje e sipër kundërvajtjen në fushën e infrastrukturës publike, vendos menjëherë dënimin me gjobë sipas parashikimeve të kësaj pike dhe në çdo rast njofton Koordinatorët e Mbrojtjes së Konsumatorit për përlllogaritjen e dëmit dhe shpërblimin e tij nga kundërvajtësi. Në këtë rast Policia Bashkiake vendos në dispozicion të Koordinatorët e Mbrojtjes së Konsumatorit një kopje të procesverbalit të gjobës

#### **Neni 17**

##### **Shpërblimi i dëmit dhe përlllogaritja e tij**

1. Nëse struktura konstatuese, konstaton shkaktim dëmi që vjen si pasojë e kundërvajtjes administrative, menjëherë pas vendosjes së gjobës për kundërvajtjen administrative, njofton strukturën përkatëse që është përgjegjëse për përlllogaritjen e dëmit të shkaktuar dhe dëmshpërblimin e tij.
2. Struktura përgjegjëse vlerëson masën e dëmit dhe me një akt administrativ më vete vendos masën dhe mënyrën e shpërblimit të dëmit.



3. Shpërblimi i dëmit kryhet nëpërmjet zëvendësimit apo kthimit në gjendjen e mëparshme të pronës publike, sendit/objektit/hapësirës së dëmtuar ose duke paguar kundërvleftën monetare të dëmit të shkaktuar.

4. Përlllogaritja e dëmit të kryhet sipas kësaj formule:  $Dm = TSDm \times KRb$   $TSDm = \text{totali i sendeve të dëmtuara}$ ;  $KRb = \text{kosto për kthimin në gjendjen e mëparshme të sendit të dëmtuar e cila përlllogaritet sipas Aneksit nr. 1, nr.2 dhe nr.3 bashkëlidhur këtij vendimi}$ .

5. Struktura përgjegjëse për shqyrtimin përlllogaritjen e dëmit është Koordinatori për Mbrojtjen e Konsumatorit, Policia Bashkiake në varesi të shkeljes së konstatuar.

### **Neni 18**

#### **Mënyra e caktimit të dënimit**

1. Sanksioni administrativ që zbatohet për çdo shkelje caktohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit në raport me shkeljen e konstatuar, dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative mbi kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe dispozitat e këtij vendimi.

2. Nëse personi fizik ose personi juridik ka kryer më shumë se një kundërvajtje nga ato të parashikuara nga ky vendim, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor, dënimi jepet për çdo kundërvajtje.

3. Në rastin kur disa kundërvajtje të kryera nga i njëjti person, konstatohen dhe shqyrtohen nëpërmjet të njëjtit procesverbal, caktohet një dënim me gjobë që përbëhet nga bashkimi i dënimeve me gjobë për secilën nga kundërvajtjet por jo më shumë se dyfishi i masës së gjobës së parashikuar për kundërvajtjen më të rëndë.

4. Nëse në kryerjen e kundërvajtjes kanë marrë pjesë më shumë se një person, dënimi jepet në mënyrë të veçantë për secilin kundërvajtës.

### **Neni 19**

#### **Rrethanat lehtësuese**

1. Lehtësojnë sanksionin administrativ këto rrethana:

- a. kundërvajtësi shpreh pendesë për veprimin e kryer;
- b. kundërvajtësi ka eliminuar vullnetarisht pasojat e ardhura nga shkelja e kryer, ka kompensuar humbjen ose eliminuar dënimin e kryer;
- c. kundërvajtja është kryer për shkak të rrethanave të rënda personale ose familjare;
- d. kundërvajtja është kryer nga një grua shtatzënë.

2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënim administrativ me paralajmërim ose dënim administrativ në minimum të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje.

### **Neni 20**

#### **Rrethanat rënduese**



1. Rëndojnë sanksionin administrativ këto rrethana:

- a. kundërvajtësi vazhdon veprimtarinë e paligjshme edhe mbas kërkesës për ta ndërprerë atë;
  - b. kundërvajtja është kryer nga më shumë se një individ apo grup individësh;
  - c. kundërvajtja është kryer gjatë një fatkeqësie natyrore ose rrethana të tjera të gjendjes së jashtëzakonshme;
  - d. kundërvajtja është kryer nën ndikimin e pijeve alkoolike, narkotike apo psikotrope.
2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënimi me gjobë në një masë afër nivelit maksimal të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje.

#### KREU IV

### KOMPETENCA DHE PROCEDURA E KONSTATIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE ZBATIMI I TYRE

#### Neni 21

#### **Kompetenca për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore**

1. Strukturat konstatuese janë përgjegjëse për konstatimin dhe shqyrtimin e të gjitha kundërvajtjeve të parashikuara në këtë vendim, si edhe të çdo shkeljeje tjetër të përcaktuar nga këshilli bashkiak i Rogozhines apo kryetari i Bashkisë Rogozhinë.
2. Kundërvajtjet administrative, sipas këtij vendimi, konstatohen dhe shqyrtohen gjatë veprimtarisë rutinë të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ose sipas sinjalizimeve apo ankimeve të individëve dhe qytetarëve të ndryshëm.
3. Gjatë procedurës për konstatimin dhe shqyrtimin e një kundërvajtje administrative, strukturat konstatuese të Bashkisë Rogozhinë, nëse e sheh të nevojshme, ka të drejtën të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit të dyshuar për kryerjen e kundërvajtjes apo shkeljes së konstatuar.

#### Neni 22

#### **Procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve**

1. Struktura përkatëse qëkonstaton kundërvajtjen dhe e shqyrton atë menjëherë në vendin e kryerjes së saj.
2. Konstatimi dhe shqyrtimi i një kundërvajtje pasqyrohet në procesverbalin e kundërvajtjes, i cili përfshin, dënimin administrativ që jepet dhe sipas rastit shpërblimi dhe përlllogaritja e dëmit të shkaktuar. Procesverbali është akt administrativ.
3. Përpara nënshkrimit të procesverbalit të konstatimit dhe vendosjes së gjobës polici bashkiak i shpjegon kundërvajtësit shkeljen faktike të kryer, bazën ligjore për konsiderimin e saj si kundërvajtje administrative dhe dënimin administrativ që zbatohet. Kundërvajtësit i jepet mundësia për të paraqitur, aty për aty, komentet dhe shpjegimet përkatëse.
4. Procesverbali, si rregull, hartohet në prani të kundërvajtësit. Ai nënshkruhet nga punonjësi i strukturës përkatëse që konstaton kundërvajtjen, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në



rast se ka të tillë. Në rastet kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, refuzon të nënshkruajë, nuk mundet të nënshkruajë apo refuzon të marrë procesverbalin, punonjësi konstatues bën një shënim të posaçëm në procesverbal dhe e vërteton këtë fakt nëpërmjet të paktën një dëshmitari.

5. Një kopje e procesverbalit i njoftohet kundërvajtësit nëpërmjet dorëzimit në vend. Në rastet kur kundërvajtësi refuzon të marrë kopjen e procesverbalit, ai konsiderohet i njoftuar. Në rastet kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, procesverbali njoftohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

Dëshmitar, sipas pikës 4 të këtij neni, mund të jetë çdo person fizik me zotësi të plotë për të vepruar sipas përcaktimit të Kodit Civil, përfshirë këtu edhe një agjent tjetër konstatues.

### **Neni 23**

#### **Procesverbali dhe baza e të dhënave**

1. Modeli i procesverbalit për kundërvajtjen administrative dhe procesverbali për shpërblimin e dëmit miratohen nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjen administrative.
2. Kryetari i Bashkisë, miraton rregullat për krijimin, administrimin të bazës së të dhënave për kundërvajtjet administrative, ku përfshihen, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave dhe nivelin e aksesit në këtë bazë të dhënash.

### **Neni 24**

#### **Ankimi administrativ**


1. Kundër procesverbalit nëpërmjet të cilit është vendosur sanksioni administrativ me gjobë mund të paraqitet ankim administrativ në Gjykatën kompetete, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
2. Në rast lënies në fuqi të dënimit, gjoba paguhet në afatin e caktuar në vendimin e Gjykatës kompetente, apo në mungesë të një parashikimi të tillë në çastin kur vendimi hyn në fuqi.

### **Neni 25**

#### **Zbatimi vullnetar**

1. Gjobat paguhet vullnetarisht brenda 10 ditëve nga data kur gjoba bëhet e ekzekutueshme.
2. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, zbatohet një kamatëvonesë prej 2% (dy për qind) mbi masën e gjobës, për çdo ditë vonesë. Shuma totale e kamatëvonesave nuk mund të tejkalojë masën e gjobës.
3. Nëse gjoba paguhet vullnetarisht brenda 5 ditëve nga data kur ai bëhet i ekzekutueshëm sipas Kodit të Procedurës Administrative, aplikohet një zbritje prej 20% të masës të gjobës.
4. Pagesa vullnetare e gjobës dhe ose/kamatëvonesa bëhet në llogarinë bankare të strukturës që ka vendosur sanksionin administrativ.

### **Neni 26**



### **Ekzekutimi i dënimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv**

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë apo shpërblimin e dëmit, i vendosur nga strukturat kontestuese në zbatim të këtij vendimi përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i tyre kryhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Në rast se nga aktet ligjore e nënligjore nuk parashikohet ndryshe, Drejtoria e te Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik është struktura përgjegjëse për arkëtimin dhe ekzekutimin e detyrueshëm të tyre.
3. Të ardhurat nga gjobat dhe për kundërvajtjet dhe shpërblimin e dëmeve të parashikuara nga ky vendim, kalojnë tërësisht në buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

### **Neni 27**

#### **Procedurat e veprimit në rastin e kundërvajtjeve të tjera**

Kur struktura konstatuese krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim ose mosveprim i një personi fizik ose juridik, përbën një kundërvajtje administrative, konstatimi dhe shqyrtimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i pariparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtësit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.

### **KREU V DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 28 Dispozita kalimtare**

1. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si klube që janë burim i ndotjes akustike dhe pamore për banorët dhe qytetin e Rrogozhinës, marrin masat e menjëhershme për zhvendosjen e aktivitetit të tyre brenda datës **31 janar 2025**, jashtë perimetrit të caktuar sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Me kalimin e afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, çdo subjekt që vazhdon të ushtrojë ende aktivitetin në kundërshtim me këtë vendim, përbën kundërvajtje administrative dhe përveç dënimit me gjobë sipas këtij vendimi procedohet menjëherë edhe me mbylljen e aktivitetit nga Policia Bashkiake .



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**Neni 29**

**Urdhrat dhe vendimet**

Ngarkohet kryetari i Bashkisë Rrogozhine që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratoj urdhrat dhe vendimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi. Për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë miraton formularët përkatës që duhet të përdoren nga strukturat konstatuese të Bashkisë Rrogozhine.

**Neni 30**

**Strukturat që ngarkohen me zbatimin e vendimit**

Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Finances, Policia Bashkiake, Koordinatorët e Mbrojtjes së Konsumatorit si edhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

**Neni 31**

**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas dhe konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**MUKADES GIXHAB**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4 Prot.

Rrogozhinë, më 29.01.2024

**VENDIM**

Nr. 4 , datë 29. 01. 2024

**PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT, “TUNGJATJETA  
JETË, SHËRBIM LËVIZËS PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR” PËR VITIN  
2024**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 29.01.2024 mori në shqyrtim projektvendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.362/1.Prot datë 29.01.2024 “Për projektin : Tungjatjeta jetë, Shërbim Lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar”*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “ , i ndryshuar, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr.97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024” të ligjit nr.121 datë 21.11.2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, shkresës nr.416/29.prot datë 23.01.2024 “Njoftim” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Bashkinë Rrogozhinë, me protokoll hyrës të Bashkisë Rrogozhinë Nr.362.Prot datë 26.01.2024. Mbi miratimin e shumës prej 2.192.016 (dymilion e njëqind e nëntëdhjetë e dymijë e gjashtëmbëdhjetë) lekë , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e fondit për Projektin me titull : “Tungjatjeta Jetë, Shërbim Lëvizës për Fëmijë me Aftësi të Kufizuar” të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024, sipas buxhetit të detajuar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi **me fond total 4,493,616** (katërmilion e katërqind e nëntëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.
- Nga ku rreth 50% të vlerës totale për përballimin e këtij projekti **me fond 2,192,016** (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëmbëdhjetë) lekë do të mbulohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas fondit të akorduar në shkresën bashkëlidhur këtij vendimi.
- Dhe pjesa tjetër e **fondit në masën 2,301,600** (dy milion e treqind e njëmijë e gjashtëqind) lekë do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Financës dhe Sektori i Shërbimit Social pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7 Prot.

Rrogozhinë, më 12.02.2024

**VENDIM**

Nr. 5 , datë 12. 02. 2024

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË KËRKESËS PËR BASHKËFINANCIM PËR  
NDËRTIMIN E SHKOLLËS 9-VJEÇARE SPILLE, NJËSIA ADMINISTRATIVE  
KRYEVIDH**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 12.02.2024 mori në shqyrtim projekt-vendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.592.Prot datë 19.02.2024 "Për miratimin në parim të kërkesës për bashkëfinancim për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare dhe kopshtit Spille, Njësia Administrative Kryevidh".*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 15 të ligjit Nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", të Udhëzimit nr.9, datë 27.04.2024 "Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrje dhe për dokumentimin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financim/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollë dhe sportive", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin në parim të kërkesës për aplikim sipas shpalljes së thirrjeve për bashkëfinancim, për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare dhe kopshtit Spille, Njësia Administrative Kryevidh sipas shtojcës 1, pika (a) të Udhëzimit nr.9, datë 27.04.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
2. Marrjen përsipër në momentin e fitimit të projektit, të vlerës që i takon bashkëfinancimit të Bashkisë në masën 21,634,349.5 (njëzet e një milion e gjashtëqind e tridhjetë e katërmijë e treqind e dyzet e nëntë, pikë pesë) lekë nga zëri buxhetor 00/9120/05/2312103, pra 15 % e vlerës totale të 144,228,996.8 (njëqind e dyzet e katër milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë, pikë tetë) lekë të preventivit të projektit të pasqyruar në aplikim.

---

**Adresa:** BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

3. Pas konfirmimit nga ana e Prefekturës ky vendim i bashkëngjitet aplikimit dhe dorëzohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Politikave Urbane, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Arsimit pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT

MUKADES GIXHARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8 Prot.

Rrogozhinë, më 12.02.2024

**VENDIM**

Nr. 6 , datë 12. 02. 2024

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË KËRKESËS PËR BASHKËFINANCIM PËR  
RIKONSTRUKSION TË BANESAVE, BASHKIA RROGOZHINË**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 12.02.2024 mori në shqyrtim projekt-vendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.591.Prot datë 19.02.2024 “Për miratimin në parim të kërkesës për bashkëfinancim për rikonstruksion të banesave, Bashkia Rrogozhinë “.*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ” i ndryshuar, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 15 të ligjit Nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, lidhja 1 “Termat e referencës për projektet e investimet që do të financohen nga Buxheti i Shtetit për vitet 2024-2025”, “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe për dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financim/ bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës të banesave private”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin në parim të kërkesës për aplikim sipas shpalljes së thirrjeve për bashkëfinancim, për rikonstruksion të banesave në territorin e Bashkisë Rrogozhinë sipas preventivit bashkëlidhur.
2. Marrjen përsipër në momentin e fitimit të projektit, të vlerës që i takon bashkëfinancimit të Bashkisë në masën 9,261,300 (nëntë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind) lekë nga zëri buxhetor 00/1110/05/2312118, pra 30 % e vlerës totale të 30,871,000 (tridhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e një mijë) lekë të preventivit të projektit të pasqyruar në aplikim.

---

**Adresa:** BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

3. Pas konfirmimit nga ana e Prefekturës ky vendim i bashkëngjitet aplikimit dhe dorëzohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Politikave Urbane, Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Rrogozhinë.

**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.**

**KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 11 Prot.

Rrogozhinë, më 27.02.2024

**VENDIM**

Nr. 7 , datë 27.02.2024

**PËR PRANIMIN E DORËHEQJES NGA MANDATI I KËSHILLTARIT TË  
Z. FERDI AVDIU**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 27.02.2024 analizoi dhe diskutoi në lidhje me kërkesën me Nr.762.Prot datë 20.02.2024 për dorëheqjen nga mandati i Këshilltarit të z. Ferdi Avdiu .*


Në mbështetje të nenit 49 pika 1, nenit 54 gërma “j” ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore“ , i ndryshuar, Rregullores “Për organizmin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë” me propozim të komisionit të Mandateve, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të pranojë dorëheqjen e z. Ferdi Nexhip Avdiu nga mandati i anëtarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë, kandidat i dalë nga lista shumëëmërore për këshilltarë të subjektit politik Partia Republikane e Shqipërisë (PR).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI**

**Adresa:** BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 12 Prot.

Rrogozhinë, më 27.02.2024

**VENDIM**

Nr. 8 , datë 27. 02. 2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR  
MUAJIN JANAR 2024 NGA FONDI I BLOK – NDIHMËS 6%**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 27.02.2024 mori në shqyrtim projekt-vendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.749.Prot datë 19.02.2024 “Për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% ”.*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “ , i ndryshuar Ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” Kreu II pika 13 e VKM-së nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6 %” . Me propozim të komisionit të ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 159 datë 17.06.2020 “Për verifikimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i bllok - ndihmës 6 %.
- Në total 20 familje që plotësojnë të gjithë kriteret juridike dhe ekonomike për marrjen e ndihmës ekonomike.
2. Fondi total prej 74 405 (shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesë) lekë.
3. Këto familje trajtohen në një listë të veçantë me fondin 6% të bllok Ndihmës - Ekonomike, lista si më poshtë vijon :

---

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



**Njësia Gosë Shuma që përfitojnë**

|                 |            |
|-----------------|------------|
| 1- Jeta Bisku   | 5 445 lekë |
| 2- Ali Vogli    | 3 703 lekë |
| 3- Xhevdet Rosa | 4 752 lekë |
| 4- Atlije Huqi  | 5 940 lekë |
| 5- Rudin Aliu   | 3 703 lekë |
| 6- Luman Murati | 3 703 lekë |

**Njësia Lekaj Shuma që përfitojnë**

|                   |            |
|-------------------|------------|
| 1- Florinda Dedej | 1 525 lekë |
| 2- Bashkim Shaba  | 3 703 lekë |

**Njësia Kryevidh Shuma që përfitojnë**

|                  |            |
|------------------|------------|
| 1- Shyqyri Elezi | 3 703 lekë |
| 2- File Osma     | 3 146 lekë |

**Njësia Rrogozhinë Shuma që përfitojnë**

|                     |            |
|---------------------|------------|
| 1- Jeta Tosku       | 3 146 lekë |
| 2- Sami Memolla     | 3 703 lekë |
| 3- Hajrije Xhavara  | 3 703 lekë |
| 4- Fitnete Arapi    | 3 146 lekë |
| 5- Prandvera Andoni | 2 178 lekë |
| 6- Shpetim Fejzo    | 2 178 lekë |
| 7- Lindita Kashari  | 2 178 lekë |
| 8- Brunilda Sina    | 5 940 lekë |
| 9- Gezim Deda       | 2 178 lekë |
| 10- Mynyre Kuka     | 6 732 lekë |

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Rrogozhinë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI



---

**Adresa:** BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 13 Prot.

Rrogozhinë, më 27.02.2024

**VENDIM**

Nr. 9 , datë 27.02.2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR  
MUAJIN SHKURT 2024 NGA FONDI I PUSHTETIT VENDOR**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 27.02.2024 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.644.Prot datë 13.02.2024, "Për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i pushtetit vendor".*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 " Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", VKM-së Nr.597, datë .04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", VKB-së Nr.38, datë 27.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024", VKB-së Nr. 3 . datë 27.01.2020 "Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor", Me propozim të komisionit "Për verifikimin e familjeve që jetojnë në vështirësi ekonomike" ngritur me Urdhërin e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Nr.84, datë 13.02.2023 , Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i pushtetit vendor.
  - Në total 17 familje që plotësojnë të gjithë kriteret juridike dhe ekonomike për marrjen e ndihmës ekonomike .
2. Fondi total prej 69 192 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntë dhjetë e dy) lekë.

---

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA RROGOZHINË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

3. Këto familje trajtohen në një listë të veçantë me fondin e Buxhetit Vendor, në zërin Buxhetor Ndhimja Ekonomike për vitin 2024 llogaria 606-1004, lista si më poshtë vijon :


| Emër         | Atësi   | Mbiemër    | Shuma       | Nr. identifikimit | Vendbanimi |
|--------------|---------|------------|-------------|-------------------|------------|
| 1- Landa     | Abaz    | Meka       | 5 220 lekë  | H75221052C        | Rrogozhinë |
| 2- Ervin     | Banush  | Murrani    | 1 800 lekë  | I30206046I        | Rrogozhinë |
| 3- Vjollca   | Shyqyri | Gjini      | 3 060 lekë  | H25607036D        | Rrogozhinë |
| 4- Fiqiri    | Tafil   | Hunçi      | 5 220 lekë  | H60120050N        | Rrogozhinë |
| 5- Manola    | Syrja   | Serani     | 3 060 lekë  | H45608040P        | Gosë       |
| 6- Arjana    | Zyber   | Bubeqi     | 3 960 lekë  | I35612019R        | Kryevidh   |
| 7- Etleva    | Gezim   | Xhafa      | 12 672 lekë | I55310191V        | Rrogozhinë |
| 8- Luljeta   | Halit   | Kapllani   | 3 060 lekë  | G95220065G        | Sinaballaj |
| 9- Vera      | Haki    | Allko      | 3 960 lekë  | H65311042Q        | Sinaballaj |
| 10- Pranvera | Nevrus  | Met-hasani | 3 960 lekë  | J35411088C        | Sinaballaj |
| 11- Irma     | Sinan   | Kodralliu  | 3 960 lekë  | I65906024M        | Rrogozhinë |
| 12- Antonela | Enver   | Kasula     | 1 800 lekë  | G95728082F        | Rrogozhinë |
| 13- Shaban   | Xhaferr | Memolla    | 4 320 lekë  | G61210047Q        | Rrogozhinë |
| 14- Xhemile  | Murat   | Pepa       | 4 320 lekë  | H65421044Q        | Gosë       |
| 15- Raimonda | Thoma   | Gjuzi      | 1 800 lekë  | G76215043U        | Rrogozhinë |
| 16- Florenc  | Agron   | Deda       | 1 800 lekë  | J50824064C        | Rrogozhinë |
| 17- Drita    | Liman   | Haska      | 5 220 lekë  | H16005036W        | Lekaj      |

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**MUKADES GIXHARI**



Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shkurtori” Email: brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 14 Prot.

Rrogozhinë, më 27.02.2024

**VENDIM**

Nr. 10 , datë 27.02.2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE FAMILJES SË TË NDJERIT  
BAJAZIT THAÇI**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 27.02.2024 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Bashkia, me shkresë Nr.775.Prot datë 20.02.2024 "Për dhënie e ndihmës financiare familjes së të ndjerit Bajazit Thaçi", projektvendimin e propozuar nga Këshilli Bashkiak me Nr.775/1.Prot datë 27.02.2024 "Për një shtesë në projektvendimin, 'Për dhënie e ndihmës financiare familjes së të ndjerit z. Bajazit Thaçi' ", si dhe Relacionin me Nr.775/2.Prot datë 27.02.2024.*

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " , Ligjit Nr. 57/2019 ,datë 18.07.2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" VKB-së Nr.38, datë 27.12.2023 " Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024" Me propozim të Këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë , Këshilli Bashkiak :

**V E N D O S I :**

- 1 . T'i jepet ndihmë financiare e menjëhershme familjes së të ndjerit z. Bajazit Thaçi ish anëtar i Këshillit Bashkiak i ndarë nga jeta fatkeqësisht me datë 16.11.2023, në masën 500 000 (pesë qind mijë) lekë.
2. Shpenzimi do të përballohet nga Buxheti i Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024, parashikuar në zërin Buxhetor 1110/05/606 1041.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe e Shërbimit Social pranë Bashkisë Rrogozhinë.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 15 Prot.

Rrogozhinë, më 27.02.2024

**VENDIM**

Nr. 11 , datë 27.02.2024

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK  
ZNJ. MERILIN SARAÇI**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 27.02.2024 analizoi dhe diskutoi në lidhje me shkresën e ardhur nga KQZ me Nr.444. Prot datë 14.02.2024 “Njoftim për vazhdimin procedurave për dhënie e mandatit”.*

Në mbështetje të nenit 49 pika 1, nenit 54 gërma “j” të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Rregullores “Për organizmin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, mbështetur në Vendimin e KQZ-së, Nr.11 datë 02.02.2024, me propozim të komisionit të Mandateve, Këshilli Bashkiak,

**VENDOSI :**

1. Ti japë mandatin e anëtarit të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë kandidates në listën shumëëmërore të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë znj. Merilin Artur Saraçi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI**



Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 18 Prot.

Rrogozhinë, më 26.03.2024

**VENDIM**

Nr. 12 , datë 26. 03. 2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR  
MUAJIN SHKURT 2024 NGA FONDI I BLOK – NDIHMËS 6%**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 26.03.2024 mori në shqyrtim projekt-vendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1080.Prot datë 13.03.2024 “Për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% ”.*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “ , i ndryshuar Ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” Kreu II pika 13 e VKM-së nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6 %” . Me propozim të komisionit të ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 159 datë 17.06.2020 “Për verifikimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i bllok - ndihmës 6 %.
- Në total 20 familje që plotësojnë të gjithë kriteret juridike dhe ekonomike për marrjen e ndihmës ekonomike.
2. Fondi total prej 79 141 (shtatëdhjetë e nntw mijw e njwqind e dyzet e njw) lekë.
3. Këto familje trajtohen në një listë të veçantë me fondin 6% të bllok Ndihmës - Ekonomike, lista si më poshtë vijon :

---

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



**Njësia Gosë Shuma që përfitojnë**

|                 |            |
|-----------------|------------|
| 1- Jeta Bisku   | 5 445 lekë |
| 2- Ali Vogli    | 3 703 lekë |
| 3- Nazmi Saraçi | 3 703 lekë |
| 4- Atlije Huqi  | 5 940 lekë |
| 5- Rudin Aliu   | 3 703 lekë |
| 6- Luman Murati | 3 703 lekë |
| 7- Agron Shehi  | 1 525 lekë |

**Njësia Lekaj Shuma që përfitojnë**

|                   |            |
|-------------------|------------|
| 1- Florinda Dedej | 1 525 lekë |
| 2- Bashkim Shaba  | 3 703 lekë |

**Njësia Kryevidh Shuma që përfitojnë**

|              |            |
|--------------|------------|
| 1- Zini Muça | 5 881 lekë |
| 2- File Osma | 3 146 lekë |
| 3- Laz Shuli | 5 881 lekë |

**Njësia Rrogozhinë Shuma që përfitojnë**

|                    |            |
|--------------------|------------|
| 1- Jeta Tosku      | 3 146 lekë |
| 2- Sami Memolla    | 3 703 lekë |
| 3- Shpetim Fejzo   | 2 178 lekë |
| 4- Isa Tusku       | 3 703 lekë |
| 5- Brunilda Sina   | 5 940 lekë |
| 6- Gezim Deda      | 2 178 lekë |
| 7- Mynyre Kuka     | 6 732 lekë |
| 8- Mit-hat Xhavara | 3 703 lekë |

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Rrogozhinë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 19 Prot.

Rrogozhinë, më 26.03.2024

**VENDIM**

Nr. 13 , datë 26.03.2024

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR  
MUAJIN MARS 2024 NGA FONDI I PUSHTETIT VENDOR**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 26.03.2024 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1123.Prot datë 19.03.2024, "Për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2024 nga fondi i pushtetit vendor".*

Në mbështetje të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 " Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", VKM-së Nr.597, datë .04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", VKB-së Nr.38, datë 27.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024", VKB-së Nr. 3 . datë 27.01.2020 "Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor", Me propozim të komisionit "Për verifikimin e familjeve që jetojnë në vështirësi ekonomike" ngritur me Urdhërin e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Nr.84, datë 13.02.2023 , Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë dhënie e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2024 nga fondi i pushtetit vendor.
  - Në total 23 familje që plotësojnë të gjithë kriteret juridike dhe ekonomike për marrjen e ndihmës ekonomike .
2. Fondi total prej 87 012 (tetëdhjetë e shtatë mijë e dymbëdhjetë) lekë.
3. Këto familje trajtohen në një listë të veçantë me fondin e Buxhetit Vendor, në zërin Buxhetor Ndhma Ekonomike për vitin 2024 llogaria 606-1004, lista si më poshtë vijon :

---

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA RROGOZHINË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

| Emër         | Atësi   | Mbiemër    | Shuma       | Nr. identifikimit | Vendbanimi |
|--------------|---------|------------|-------------|-------------------|------------|
| 1- Vjollca   | Shyqyri | Gjini      | 3 060 lekë  | H25607036D        | Rrogozhinë |
| 2- Fiqiri    | Tafil   | Hunçi      | 5 220 lekë  | H60120050N        | Rrogozhinë |
| 3- Manola    | Syrja   | Serani     | 3 060 lekë  | H45608040P        | Gosë       |
| 4- Arjana    | Zyber   | Bubeqi     | 3 960 lekë  | I35612019R        | Kryevidh   |
| 5- Etleva    | Gezim   | Xhafa      | 12 672 lekë | I55310191V        | Rrogozhinë |
| 6- Luljeta   | Halit   | Kapllani   | 3 060 lekë  | G95220065G        | Sinaballaj |
| 7- Vera      | Haki    | Allko      | 3 960 lekë  | H65311042Q        | Sinaballaj |
| 8- Pranvera  | Nevrus  | Met-hasani | 3 960 lekë  | J35411088C        | Sinaballaj |
| 9- Irma      | Sinan   | Kodralliu  | 3 960 lekë  | I65906024M        | Rrogozhinë |
| 10- Antonela | Enver   | Kasula     | 1 800 lekë  | G95728082F        | Rrogozhinë |
| 11- Shaban   | Xhaferr | Memolla    | 4 320 lekë  | G61210047Q        | Rrogozhinë |
| 12- Xhemile  | Murat   | Pepa       | 4 320 lekë  | H65421044Q        | Gosë       |
| 13- Raimonda | Thoma   | Gjuzi      | 1 800 lekë  | G76215043U        | Rrogozhinë |
| 14- Florenc  | Agron   | Deda       | 1 800 lekë  | J50824064C        | Rrogozhinë |
| 15- Drita    | Liman   | Haska      | 5 220 lekë  | H16005036W        | Lekaj      |
| 16- Nuredin  | Ramazan | Lusha      | 1 800 lekë  | F10901186K        | Rrogozhinë |
| 17- Bedri    | Tahir   | Haskasa    | 4 320 lekë  | H60214044L        | Rrogozhinë |
| 18- Hazbiye  | Ali     | Vogli      | 3 060 lekë  | G25315342D        | Rrogozhinë |
| 19- Jeta     | Rexhep  | Tosku      | 1 800 lekë  | G25311026G        | Rrogozhinë |
| 20- Hamide   | Baki    | Ballabani  | 2 700 lekë  | J25718050G        | Rrogozhinë |
| 21- Sofije   | Naim    | Proshka    | 5 760 lekë  | I25719058F        | Rrogozhinë |
| 22- Suada    | Xhevdet | Xhavera    | 1 800 lekë  | J86107034F        | Rrogozhinë |
| 23- Brisilda | Qani    | Osma       | 3 600 lekë  | J06231039W        | Gosë       |

- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Rrogozhinë.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**MUKADES GIXHARI**



Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email: brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 20 Prot.

Rrogozhinë, më 26.03.2024

**VENDIM**

Nr. 14 , datë 26.03.2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR DHËNIEN E TITUJVE  
VENDORË TË NDERIT PËR BASHKINË RROGOZHINË**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 26 .03 .2024 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Kryetarja e Këshillit, me shkresë Nr.773.Prot datë 20.02.2024 “Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënie të titujve të nderit për Bashkinë Rrogozhinë”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.773/1.Prot datë 20.02.2024.*

Në mbështetje të gërmës “m”, neni 54, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, mbështetur në gërmën “a”, pika 1, neni 14, neni 15 të ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, tituj e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, mbështetur dhe në pikën 1, Kreu I, të VKM-së Nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie të medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Pas konsultimit me anëtarët e Këshillit Bashkiak, Këshillit Bashkiak ,

**V E N D O S I :**

1. Ngritjen e Komisionit Këshillimor për dhënie të titujve vendorë të nderit për Bashkinë Rrogozhinë, gjithsej 5 anëtarë me këtë përbërje :

- z. Xhavit Halili (personalitet i jashtëm)
- z. Bardhyl Tosku (përgjegjës i qendrës kulturore)
- z. Sokol Gosa (këshilltar, kryetar i komisionit të këshillit arsim, kulturë)
- z. Luan Gjuzi (përgjegjës i sektorit juridik)
- z. Naim Tafxhafa (personalitet i jashtëm)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

2. Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit në Bashkinë Rrogozhinë i ngritur në zbatim të këtij vendimi do të ushtrojë kompetencat e tij deri në fund të mandatit 4-vjeçar të këtij Këshilli Bashkiak ose në çdo rast ky afat shtyhet ose tjetërsohet me vendim këshilli.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Këshilli Bashkiak dhe Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit .

**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.**

**KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 21 Prot.

Rrogozhinë, më 26.03.2024

**VENDIM**

Nr. 15 , datë 26.03.2024

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS ME EFEKT FINANCIAR PREJ 50 000  
(PESËDHJETË MIJË) LEKËSH PËR FAMILJEN E Z. FATBARDH SHEFQET  
SOKOLI**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 26.03.2024 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.1199.Prot datë 26.03.2024 "Për miratimin e kërkesës me efekt financiar prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh për familjen e z. Fatbardh Shefqet Sokoli".*

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.115/2021 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022", kërkesës drejtuar Këshillit Bashkiak me Nr.1106.Prot datë 20.03.2023. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak :

**V E N D O S I :**


- 1 . Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me efekt financiar prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh për familjen e z. Fatbardh Shefqet Sokoli.“.
2. Shpenzimi do të përballohet nga Buxheti i Bashkisë. Ky zë është i parashikuar në buxhet me titull, “Shpenzime për situata të vështira dhe për fatkeqësi”.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Rrogozhinë.

**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.**

**KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GJIXHARI**



Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 24 Prot.

Rrogozhinë, më 02.04.2024

**VENDIM**

Nr. 16 , datë 02. 04. 2024

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI TË VKB-SË NR.34, DATË 27.12.2023  
“MIRATIMI I PAKETËS FISKALE VITI 2024 PËR BASHKINË RROGOZHINË”**

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 02.04.2024 mori në shqyrtim projektvendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.1268.Prot datë 29.03.2024 “Për një ndryshim të VKB-së Nr.34 datë 27.12.2023 ‘Miratimi i paketës fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë’ “, si dhe relacionin shpjegues për këtë projektvendim.*

Në mbështetje të gërmës “f” nenit 54 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar, Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 42/2015 dt.17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, VKM-së nr.130, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimit rural për vitin 2024”, Udhëzimit nr.6, datë 07.03.2024 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrat e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,


**V E N D O S I :**

1. Të miratojë ndryshimin e VKB-së nr.34, datë 27.12.2023 “Miratimi i paketës fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë”, në faqen 15 të këtij vendimi, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje :

d/1) Përfshihen nga tarifa e shkronjës “d” vërtetimet që lëshohen për fermerët që aplikojnë për skemën e karburantit në bujqësi. (Vërtetimi për fermerët që aplikojnë për subvencion naftë në bujqësi të lëshohet me citimin: “Lëshohet vërtetimi për aplikim për skemën e karburantit në bujqësi”).

---

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjithë Drejtoritë dhe zyrat e Bashkisë Rrogozhinë dhe Institucionet në varësi të saj.**

**Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.**

**KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI**

